

Datë 22.04.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbime printimi për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79810000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 34,999,700 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH ose 354,751 (treqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një) euro pa TVSH.

Kursi i këmbimit sipas Bankes së Shqipërisë datë 22.04.2025

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:** Sipas shtojcës 9.

2.2 **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se vlera e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr.7998 datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

Emertimi	Njësi	Sasi
Printer/fotokopje/skaner/bardh/zi A4	copë	221
Pajisje printer/fotokopje/skaner/me ngjyra A4	copë	27
Pajisje printer/fotokopje/skaner A3/ bardh/zi	copë	7

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Pajisje te kerkuara nga autoriteti kontraktor perfitues fundor i ketij sherbimi.

2.3.3 Për pajisjet e kërkuara në pikën 2.3.2, operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve, në mënyrë

që të krahasohet pajtueshmeria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar shërbimin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të shërbimeve, objekt prokurimi.

2.3.4 Për artikujt “Letër” operatori ofertues duhet të paraqesë katalog/broshurë/skedën teknike, në të cilën të përfshihen specifikimet teknike të kërkuara me produktet e ofruara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar shërbimin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të shërbimeve, objekt prokurimi.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

a. 5 (pesë) inxhinierë të cilët duhet të jenë të diplomuar në fushat: teknologji informacioni IT/informatike/ inovacion/ elektronike/ inxhinieri mekanike. Për keta punonjës të paraqitet diploma e arsimit të lartë dhe kontrata e punës së vlefshme me operatorin ekonomik ofertues. Kontrata e punës nuk duhet të ketë kohezgjatje më të shkurtër se afati i marreveshjes kuader. Inxhinierët në mënyrë të kombinuar mund të përmbushin një apo disa fusha të kërkuara.

b. 5 (pesë) punonjës teknikë të cilët do të kryejnë funksionin e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe do të realizojnë asistencën teknike gjatë kryerjes së shërbimit. Keta punonjës mund të jenë edhe inxhinierët e kërkuar në pikën 2.3.5.a. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë të trajnuar/certifikuar nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar të pajisjeve të ofertuara në këtë procedurë prokurimi ose nga organe të akredituar kompetente, për shërbim mirëmbajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Në lidhje me keta punonjës të paraqitet kontrata e punës së cilës duhet të ketë kohezgjatje jo më pak se afati i marreveshjes kuader dhe certifikimi përkatës.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kjo kërkesë vjen si kusht kryesor për kapacitetin profesional të OE ofertues. Profili i kërkuar lidhet ngushtë me objektin e prokurimit dhe le të hapur çdo fushë të teknologjisë së informacionit, elektronikës, inovacionit dhe çdo fushë tjetër të diplomimit në Shqipëri dhe ndërkombëtarisht që lidhet me objektin e prokurimit që është shërbim printimi dhe fotokopjimi. Kërkohet një numër prej pesë punonjësish, si numër minimal për zbatimin e grafikut të parashikuar të punës ku do të zbatohet kjo marreveshje kuader dhe numrit të lartë të pajisjeve që kërkohet të mirëmbahet.

Kërkesa për pesë punonjës teknik vjen si kërkesë e zbatimit në terren të marreveshjes kuader, të cilët do të jenë në gadishmëri për çdo pyetje, paqartësi, defekt apo çdo nevojë që lind gjatë

zbatimit të marreveshjes kuadër. Duke qenë se IEVP janë të shpërndara në të gjithë territorin e Shqipërisë është gjykuar i nevojshëm numri prej pesë inxhinierve për realizimin e objektit të prokurimit.

Shërbimi do të shtrihet në zona të ndryshme të Shqipërisë, ndaj kërkohet strukturë teknike e mjaftueshme që të mund të mbulojë të gjitha zonat në mënyrë të njëkohshme.

Prania e disa inxhinierëve lejon ndërhyrje të shpejtë, zgjidhje të defekteve dhe mbështetje teknike në terren, duke shmangur vonesat në ofrimin e shërbimit.

Pas vendosjes së printerëve, nevojitet monitorim dhe mirëmbajtje. Inxhinierët e fushave të mësipërme janë të aftë të realizojnë zbulimin e defekteve, Zëvendësim të komponentëve elektronikë/mekanikë etj. Printerët që përdoren në institucione publike mund të përpunojnë dokumente konfidenciale, Inxhinierët e IT dhe sigurisë mund të garantojnë që pajisjet të konfigurohen në mënyrë që të respektojnë protokollet e sigurisë dhe privatësisë, duke parandaluar rrjedhje informacioni. Ky është një shërbim me shtrirje të gjerë, që kërkon punonjës të certifikuar për të garantuar cilësi, siguri dhe vazhdimësi. Prandaj kërkesa për 5 inxhinierë është një kusht për suksesin e projektit.

Drejtoritë e Burgjeve ndodhen në qytete të ndryshme të vendit dhe shërbimi për printimin dhe pajisjen me printera duhet të garantojë: 1) Mbulesë të plotë territoriale, 2) Reagim të shpejtë në rast ndërhyrjeje teknike, 3) Prezencë të stafit teknik afër ose të dedikuar për rajonet përkatëse.

Kjo shpërndarje gjeografike e bën të pamundur mbulimin nga një numër më i vogël teknikësh pa rrezikuar cilësinë dhe kohëzgjatjen e reagimit.

Njesia e Prokurimit ka përcaktuar si kriter të domosdoshëm për kualifikim angazhimin e 5 **(pesë) punonjësve teknikë** të specializuar për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe asistencës teknike duke pasur parasysh : shtrirjen gjeografike të shërbimit, vëllimin e punës dhe kompleksitetin teknik, nevojën për ndërhyrje të shpejtë dhe të koordinuar, rëndësinë e vazhdimësisë së shërbimit për institucionet përfutuese (në këtë rast, Drejtoritë e Burgjeve).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/a,b,c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se riparimi i pajisjes së defektuar do të realizohet sipas përcaktimeve të vendosura në specifikimet teknike.

Argumentim:Kjo kerkese vjen si kerkese e lidhur ngushte me objektin e prokurimit si nje sherbim qe do te zbatohet prane Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë 2 (dy) mjete për transportimin e pajisjeve të kërkuara në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik.

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerases.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet e nevojshme për transportin e pajisjeve, për përmbushjen e kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor *Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve*, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh. a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

NJESIA E PROKURIMIT